

DRITË MBI FIGURËN E GJENERALIT MEHMET PASHË DERALLA

Hamdi MEDIU¹⁰⁹

UDK: 355.02(496.5)“18”

Abstrakt

Historiografia jonë duhet të reflektojë edhe më shumë për të ndriçuar tërësisht vlerat e figurave të tilla të shquara, që për arsye ideologjike sistemi monist i braktisi dhe i anatemoi. Kjo ndodhi edhe me figurën e Mehmet Pashë Derallës.

Mehmet Pashë Deralla është regjistruar në historiografinë shqiptare si një ndër protagonistët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878.

Gjeneral Mehmet Pashë Deralla ishte një nga protagonistët kryesorë të qëndresës shekullore përballë sulmeve serbo-malazeze, të cilat synonin pushtimin e Shqipërisë veriore. Nën komandën e tij, luftëtarët shqiptarë i shtypën forcat serbe në hapësirën ndërmjet Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi. Ishte kjo një rezistencë e sulmeve antishqiptare nga veriu, që krijoi kushte normale për të mundësuar celebrimin e aktit historik të ngritjes së flamurit në Vlorë.

Fjalë kyçe: Qëndresa, historiografia shqiptare, Lidhja e Prizrenit, pushtimi i Shqipërisë, Mehmet Pashë Deralla.

¹⁰⁹ Komuna e Tetovës, sektori për veprimtari publike

Tetovari - Mehmet Pashë Deralla

Historiografia jonë duhet të reflektojë edhe më shumë për të ndriçuar tërësisht vlerat e figurave të tilla të shquara, që për arsye ideologjike sistemi monist i braktisi dhe i anatemoi. Kjo ndodhi edhe me figurën e Mehmet Pashë Derallës.

Mehmet Pashë Deralla është regjistruar në historiografinë shqiptare si një ndër protagonistët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878.

Mehmet Pashë Deralla kreu arsimin fillor në Tetovë, kurse atë të mesëm në Shkup, në periudhën kur ndjenja e fortë e lirisë dhe e shpëtimit kombëtar po ndizej me shpejtësi në të gjitha trojet shqiptare. Mehmeti, i biri i Hasan Pashë Derallës, u lind në vitin 1843, në fshatin Gradec të Pollogut, pikërisht në kohën e kryengritjes së Dervish Carës.

Këtu mund të thuhet se familja Deralla dhe familja Cara, pas kryengritjes së vitit 1843-44, kanë pas lidhje miqësore dhënie-marrjesh në mes këtyre dy familjeve. Edhe sot e kësaj dite vazhdojnë lidhjet martesore në mes këtyre dy familjeve.

Mehmet Pashë Deralla nga të parët mësoi shumë për të kaluarën e popullit të tij dhe më pas kjo ndjenjë e kultivuar tek ai, nga prindërit dhe rrethi shoqëror, e bënë gjeneralin e ardhshëm një luftëtar të paepur për lirinë e kombit të tij. Pas shkollimit në vendlindje, ai ndoqi studimet e larta në Akademinë Ushtarake të Stambollit, të cilat i përfundoi me rezultate të shkëlqyera.

Gjatë periudhës së studimeve në Stamboll i qëlloi të jetonte në një mjedis shqiptarësh të përkushtuar për çështjen e madhe të shpëtimit kombëtar, jo vetëm nga Turqia Osmane, por edhe nga shtetet e reja ballkanike, që sapo kishin dalë nga zgjedha e huaj dhe po ndërmerrnin ofensivën për të okupuar trojet shqiptare.

Koha e studimeve të Mehmet Pashë Derallës la gjurmë të thella dhe ndikoi fuqishëm në formimin e tij si atdhetar i flaktë dhe veprimtar i zjarrtë i çështjes kombëtare. Pas diplomimit, ai për disa vite do të shërbente në një regjiment këmbësorie në Anadoll dhe njëherazi do t'i jepej e drejta për të ndjekur shkollën e lartë të Shtatmadhorisë në Stamboll, që ishte niveli më i lartë i arsimimit ushtarak në Turqi.

Suksesi në karrierë, falë aftësive dhe shkallës së lartë të përkushtimit në të gjitha detyrat e ngarkuara, do të emërohet Mehmeti "pasha" që në moshën 35-vjeçare, që nënkuptonte atë të gjeneralit.

I graduar kështu me gradën më të lartë të kohës, do të niste me detyrat e reja që do t'ia besonte komanda e lartë e asaj kohe, fillimisht si komandues xhandarmërie në Bagdad të Irakut dhe, më vonë, në Halep të Sirisë, për t'u transferuar më tej në Selanik, i cili në atë periudhë përfaqësonte një nga portet më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane në Ballkan.

Nga Selaniku, Mehmet Pashë Deralla do të merrte emërimin në Vilajetin e Kosovës, për të shërbyer në kryeqendrën e tij, në Shkup, për të vijuar më vonë në funksionin e komandantit të qarkut të Prizrenit, në të cilin bënte pjesë edhe Tetova, Gjakova dhe Luma. Pikërisht me këtë detyrë, gjeneral Deralla do t'i jepte fund karrierës si oficer i ushtrisë osmane. Më tej, për të fillon një karrierë tjetër, me një profil të ri.

Ai në shenjë proteste hoqi paletat dhe yjet e gjeneralit të ushtrisë osmane dhe iu përkushtua çështjes kombëtare.

Gjenerali i ri, Mehmet Pashë Deralla, në kulmin e karrierës së tij e hoqi uniformën osmane të pashait, për të mos e veshur më kurrë gjatë gjithë jetës së tij, sepse ishte vënë në dispozicion të Ushtrisë Vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ai u emërua këshilltar i njërit prej udhëheqësve popullorë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Sulejman Vokshit.

Roli i Mehmet Pashë Derallës në çështjen kombëtare u rrit më tej në organizimin dhe drejtimin e kryengritjeve të mëdha të Kosovës të viteve 1910-1912, ku ishte përkrah burrave të kombit, që kishin në ballë Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Isa Boletinin, Riza bej Gjakovën, Idriz Seferin, Islam Spahiun e Qerim beg Begollin. Ishin këto beteja që kulmuan me atë të verës së vitit 1912, e cila shënoi marrjen e Shkupit, ish qendrës së Vilajetit të Kosovës.¹¹⁰

Pas këtij momenti, gjenerali u vu në dispozicion të Ushtrisë Vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare kulmonte një moment historik. Mehmet Pashë Deralla u caktua këshilltar i Sulejman Vokshit, i cili bënte detyrën e ministrit të Mbrojtjes të kabinetit qeveritar, që do t'i paraprinte Qeverisë së Shqipërisë së pavarur.¹¹¹

I angazhuar gjerësisht në përmbushjen e detyrave të organeve të larta të Lidhjes së Prizrenit, gjeneral Deralla u bë një nga figurat më të njohura të kohës.

Gjeneral Mehmet Pashë Deralla ishte një nga protagonistët kryesorë të qëndresës shekullore përballë sulmeve serbo-malazeze, të cilat synonin pushtimin e Shqipërisë veriore. Nën komandën e tij, luftëtarët shqiptarë i shtypën forcat serbe në hapësirën ndërmjet Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi. Ishte kjo një rezistencë e sulmeve antishqiptare nga veriu, që krijoi kushte normale për të mundur celebrimin e aktit historik të ngritjes së flamurit në Vlorë.

Në veprimtarinë e Mehmet Pashë Derallës bie në sy bashkëpunimi i ngushtë me Hasan Prishtinën, i cili e kishte bazën në afërsinë e ndjenjave atdhetare, si dhe në reputacionin e madh që kishin këta dy atdhetarë të shquar në hapësirat përkatëse nga kishin dalë, në Kosovë e Maqedoni.

¹¹⁰ Hilë Lushaku, "Pashtriku" faqe historike dhe informatike, 20.02.2013.

¹¹¹ Prof.dr.Zeqirja Idrizi, Treva e Pollogut në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1899-1913. Tetovë, 2007.

Në vitet 1908-1912, shtëpia e Derallave në Tetovë do të shndërrohej në një çerdhe të shqiptarizmit. Mehmet Pasha dhe i biri Halimi do të shiheshin kurdoherë në krye të lëvizjeve të mëdha atdhetare, duke dhënë ndihmesë jo vetëm me trimërinë, guximin, logjikën, por edhe me pasurinë e tyre. Të dy së bashku do të prisnin e do të përcillnin në shtëpinë e madhe në Tetovë, trimat patriotë e atdhetarë si Sali Gjukën, Bedri Pejanin, Bajram Currin, Isa Boletinin, Mithat Frashërin, Hamdi Ohrin dhe dhjetëra atdhetarë të tjerë nga të gjitha viset etnike shqiptare.¹¹²

Mbas Shpalljes së Pavarësisë dhe formimit të qeverisë së parë të Shqipërisë të Pavarur, kryeministri Ismail Qemali, mbështetur në meritat, kapacitetet profesionale dhe atdhedashurinë e zjarrtë të Mehmet Pashë Derallës, i ofroi postin e ministrit të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. U formua Ministria e parë e Mbrojtjes që quhej Ministria e Luftës.

Ministri i parë i luftës ishte Mehmet Pashë Deralla. Kjo ministri kishte një efektiv që përbëhej nga disa oficerë shqiptarë të ish ushtrisë turke, nënoficerë dhe popull të armatosur. Si detyrë kryesore, këto forca kishin të organizonin mbrojtjen e qytetit të Vlorës, ku ndodhej qeveria e sapo formuar dhe ta mbronte atë nga çdo lloj rreziku.

Mehmet Pashë Deralla u emërua ministër i parë i Luftës, në bazë të mbledhjes së pestë të Kuvendit Kombëtar të Vlorës, sipas votave të fituara. "Kjo zgjedhje u verifikua në seancën e pestë, e cila filloi më 3 dhjetor dhe zgjati deri më 4 dhjetor, kur u bë votimi për ministra, ku nga 63 delegatë, të pranishëm ishin vetëm 57, kurse vendi i tretë i takoi gjeneralit tetovar me 42 vota, pas Luigj Gurakuqit e Mufid Beut".

Dita e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, 4 dhjetor 1912, lidhet me emrin dhe kontributin e Mehmet Derallës, i cili u bë organizatori dhe frymëzuesi i qëndresës me armë në dorë kundër të gjitha trupave

¹¹² Eugen Shehu, Lajmi Shqip, 28 nëntor 2006.

pushtuese ballkanike që po sulmonin Shqipërinë. Ai reformoi trupat vullnetare dhe siguroi sovranitetin e Qeverisë së Vlorës.

Pikërisht në këtë kohë, mbështetur në meritat, aftësitë profesionale dhe patriotizmin e tij të zjarrtë, Mehmet Pashë Deralla u emërua nga Ismail Qemali ministër i Luftës, i të parës Qeveri Shqiptare. Nga ky moment historik e solemn, ai do të bëhej ideatori dhe frymëzuesi i të gjitha përpjekjeve në luftën me armë në dorë kundër okupatorëve ballkanikë, që synonin ta copëtonin vendin tonë në atë periudhë.

Gjeneral Mehmet Pashë Deralla, në një kohë të shkurtër krijoi strukturat e para, me trupat vullnetare, dhe siguroi sovranitetin e Qeverisë së Vlorës brenda dhe jashtë vendit, duke përligjur njëherësh edhe një mbrojtje diplomatike e ushtarake të Fuqive të Mëdha të Evropës kundër synimeve hegjemoniste të fqinjëve shovinistë ballkanikë. Për gati dy vite, Deralla kreu me përkushtim e atdhetari shembullore detyrën e ministrit të Ushtrisë e të Luftës

Më besnik deri në fund të qeverisjes së Ismail Qemalit, ngeli vetëm Mehmet Pashë Tetova. Kjo më së miri shihet kur më 30 mars të vitit 1913, Ismail Qemali u nis në krye të delegacionit të qeverisë shqiptare, ku bënë pjesë Isa Boletini dhe Luigj Gurakuqi.

Ismail Qemali, përveç delegacionit shqiptar që mbante pranë Konferencës së Ambasadorëve në Londër, dërgoi paralelisht edhe dy delegacione të tjera, një në Romë dhe një në Vjenë. Qëllimi i dërgimit ishte që të siguronin përkrahjen prej Italisë dhe Austro-Hungarisë, për mbrojtjen e çështjes shqiptare ndaj gjenocidit që ushtronin ushtritë serbo-malazeze në Shqipërinë verilindore dhe ato greke ndaj popullsisë çame.¹¹³

¹¹³ Vebi Xhemali, Shqiptarët e Maqedonisë së sotme nga Kryengritja e Dervish Cares 1843 deri te ajo e Dibrës në vitin 1913, Tetovë 2012.

Më 22 janar 1914, për t'i dhënë fund përçarjes brenda vendit, Ismail Beu Qemali dha dorëheqjen nga Qeveria, duke dorëzuar pushtetin Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, me çka kreu një akt demokratik dhe kombëtar, për t'u larguar pastaj përkohësisht edhe nga Shqipëria.

Në të njëjtën kohë pushoi edhe funksionimi i Ministrisë së Luftës. Mehmet Pashë Deralla, pas kësaj periudhe u vendos në Durrës dhe pas ardhjes së Princ Vidit në Shqipëri, së bashku me Hasan Prishtinën dhe Isa Boletinin u bashkuan me qeverisjen e Princ Vidit, për të mirën e vendit, duke e vazhduar rezistencën e armatosur kundër sunduesve serbë dhe atyre malazez.¹¹⁴

Pas dorëheqjes së Ismail Qemalit nga posti i kryeministrit dhe kthimit të Mehmet Pashë Derallës në vendlindje, serbët nuk kishin harruar familjen e Derallave, prej nga dolën trimat për mbrojtjen e trojeve shqiptare. Familja e derallave ishte në shënjestër të bullgaro-serbëve të kohës. ¹¹⁵

Ky ishte shkak që në vjeshtën e vitit 1914, Mehmet Pashë Deralla dhe i biri i tij Halim Bej Deralla do të arrestohen dhe dërgohen në burgun e Karlovës të Bullgarisë.

Ata do të akuzohen nga Gjykata ushtarake bullgare. Me ndihmën e disa atdhetarëve shqiptarë të Shkupit, do të arratisen nga burgu i Karlovës dhe do të vazhdojnë jetën nëpër vendbanimet shqiptare të Maqedonisë së sotme.

¹¹⁴ Vebi Xhemali, gazeta Dielli, 6 dhjetor 2013.

¹¹⁵ Ismail Arslani, "Distinktivi Tetovar"- (publicistikë), Tetovë 2008, faq. 43.

Përfundim

Figura e Mehmet Pashë Derallës mbetet emblematike në fazën e krijimit të shtetit shqiptar. Ngritja profesionale e gjeneralit në shkollat më elitare të Perandorisë Osmani, i jep mundësinë atij që gjithë këtë dije ta vendosë në funksion të momentit historik, në funksion të përpjekjes së shqiptarëve për themelimin e shtetit shqiptar, në një ndër kohët më të trazuara të historisë. Me kohë, gjeneral Deralla e kishte brumosur në vete ëndrrën për çlirim të shqiptarëve, duke qenë gjithnjë pranë patriotëve shqiptarë, të cilët ishin në akord më aspiratën historike.

Pikërisht këto dimensione patriotike shkrihen në figurën e gjeneral Derallës, të cilat i kishte sublimuar nga familja dhe nga treva prej nga vinte. Aftësitë e tij prej gjenerali të shkolluar dhe mbi të gjitha patriot bëjnë që ai të jetë arkitekt i forcës së parë mbrojtëse të qeverisë së parë shqiptare. Protagonizmi i tij mbetet qenësor në rrugën e krijimit të shtetit shqiptar. Ky protagonizëm njih trajektoren që nga lidhja e Prizrenit, duke kaluar nëpër të gjitha ato ngjarje vendimtare që projektojnë themelet e krijimit të shtetit shqiptar.

Duke u nisur nga këto moment, figura e Mehmet Pashë Derallës, mbetet një shtyllë e fuqishme e pavarësisë, që e merr gjithë forcën nga kualitetet e tij profesionale dhe nga brumi atdhetar i familjes prej nga vinte. Në figurën e tij mishërohet patriotizmi i biografisë së tij jetësore dhe aspirata e shqiptarëve për të qenë pjesë e popujve të lirë. Caktimi si ministër i luftës në qeverinë e Ismail Qemalit, vetëm e dëshmon përcaktimin e tij të devotshëm në rrugën e pavarësisë së shtetit shqiptar.

Ndriçimi i figurës së gjeneral Derallës i jep peshë edhe rajonit të Pollogut, në luftë për çlirimin e trojeve shqiptare dhe në tërësinë e aspiratës historike të projektimit dhe pjesëmarrjes së gjithë gjeografisë shqiptare në shpalljen dhe mirëmbajtjen e pavarësisë së shtetit shqiptar. Gjeneral Deralla mbetet figura reflektuese, shtylla e padiskutueshme e pavarësisë së Shqipërisë, e respektuar dhe e çmuar nga arkitektët dhe

bashkëpjesëmarrësit, themeluesit e shtetit shqiptar. Ai është njëri ndër themeluesit dhe projektuesit e shtetit shqiptar, realizues i aspiratës historike të shqiptarëve.

Literatura

-Ramiz Abdyli, Shkupi në duart e kryengritësve shqiptar më 1912 sipas burimeve bullgare, "Kërkime Historike", Shkup, 1993, nr 1.

-Ismail Arslani, "Distinktivi Tetovar", Tetovë 2008.

-Zeqirja Idrizi, "Treva e Pollogut në lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1899-1913", Tetovë 2007.

-Vebi Xhemaili, " Shqiptarët e Maqedonisë së sotme nga Kryengritja e Dervish Cares 1843 deri te ajo e Dibrës në vitin 1913, Tetovë 2012."

- Hilë Lushaku, "Pashtriku", faqe historike dhe informatike, 20.02.2013.

- Eugen Shehu, Lajmi Shqip, 28 nëntor 2006.

-Ali Vishku, "Kongreset e Alfabetit dhe të Shkollës Shqipe", Shkup, 1992.

-"Tetovo i Tetovsko niz istorijata", Tetovë, 1982.

-Skender Rizaj, "Roli i Shqiptarëve në revolucionin xhonturk të vitit 1908, "Kosova" nr. 3, Prishtinë 1974.

-Halim Purellku, Shqiptarët e Republikës së Maqedonisë gjatë Luftës së Parë Ballkanike (1912), Kërkime Historike, nr. 1, Shkup, 1993.

-Kristaq Prifti, Lidhja Shqiptare e Pejës, Lëvizja Kombëtare 1896-1900, Tiranë, 2002.

-Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi II, Prishtinë 1965. -Historia e Shqipërisë, Tiranë 2002